


European
Policy
Institute.
Skopje



Institute for Democracy
Societas Civilis - Skopje



ЕВРОТИНК
ЦЕНТАР ЗА
ЕВРОПСКИ СТРАТЕГИИ

CENTER FOR
EUROPEAN STRATEGIES
EUROTHINK
eurothink.mk

Të gjithë ju do të tradhtoni BE-në sonte! Flisni tani ose heshtni përgjithmonë!

Qytetarët e Maqedonisë së Veriut kanë pritje legjitime për të filluar negociatat e anëtarësimit me BE-në tani. Maqedonia e Veriut ka ndjekur reforma të vështira dhe ka bërë kompromise të papara. Vendi ynë madje ndryshoi emrin kushtetues, duke qenë i nxitur nga premtimi për anëtarësim në BE.

Megjithatë, në Këshillin e Çështjeve të Përgjithshme nesër ka gjasa të jemi dëshmitarë të një tradhëtie të rradhës. Kjo jo vetëm që do të jetë tradhëti ndaj qytetarëve, por edhe ndaj vlerave themeluese të BE-së, si dhe interesave të saj thelbësorë strategjikë.

Kërkesat bullgare në Pozicionin Kornizë të Tetorit 2019 dhe deklaratat që pasuan bazohen në keqinterpretimin e Marrëveshjes të Miqësisë, Marrëdhënieve të Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit të nënshkruar midis dy vendeve "me vullnet të mirë". Pala bullgare përdor pozicionin e një vendi anëtar të BE-së për të imponuar interpretimin e saj të Marrëveshjes. Ajo po imponon versionin e saj të historisë në Maqedoninë e Veriut dhe po mohon identitetin maqedonas, përfshirë gjuhën maqedonase duke shkelur kështu të drejtën e vetëvendosjes. Përmes procesit të anëtarësimit, Bullgaria po kërkon gjithashtu një miratim të (keq)interpretimit të saj të një pjese të rëndësishme të historisë evropiane nga vendet e tjera të BE-së.

Për më tepër, pozicioni bullgar është në kundërshtim dhe kështu delegjitimon Marrëveshjen e Prespës midis Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, të cilën BE e vlerësoi dy vjet më parë si një shembull i zgjidhjes së çështjeve dypalëshe në rajon. Marrëveshja e Prespës tregoi qartë gatishmërinë e Maqedonisë së Veriut jo vetëm për të gjetur kompromise por edhe për të respektuar marrëveshjet e saj dhe për t'i zbatuar ato duke i dhënë fund një mosmarrëveshje të gjatë gati tre dekadash brenda KB.

Bllokimi i mundshëm i kornizës negociuese dhe deklaratat e fundit nga zyrtarë bullgarë që mohojnë identitetin maqedonas, kanë zhgënjyer thellë qytetarët e Maqedonisë së Veriut. Në vend të një të ardhme të përbashkët evropiane, ata përballen me ultimatumë që nuk kanë të drejtën t'i pranojnë. Qytetarët e Maqedonisë së Veriut janë të përgatitur për një proces anëtarësimi bazuar në vlerat dhe standardet e përbashkëta të BE-së, por jo si një instrument për ndryshimin e identitetit të tyre.

Nënshtrimi ndaj kërkesave Bullgare, të pabazuara në acquis dhe standardet ndërkombëtare, jo vetëm që do të tradhtonte Maqedoninë e Veriut, por edhe do të shkatërrojë besueshmërinë e BE-së në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe si një partner i Ballkanit Perëndimor, do të destabilizojë kufijtë e jashtëm të BE-së, do të eutanizojë procesin e zgjerimit në përgjithësi dhe do të shkatërrojë politikën e kushtëzimit.

Është dobësuar përgjigja e BE-së ndaj sfidave të brendshme dhe të jashtme

Një "jo" për procesin e pranimit në BE të Maqedonisë së Veriut do të ketë pasoja të rënda sigurie për rajonin dhe menaxhimin e kufijve të jashtëm të BE-së.

Kontestet ballkanike do të vazhdojnë të zgjasin me skenarë të mundshëm konfliktesh dhe pa asnjë nxitje për politikanët që të bien dakord për kompromise të vështira. Synimet e këtij Komisioni gjeopolitik do të shkatërrohen nëse BE nuk arrin të japë rezultate në Ballkan. Një veto në këtë rast vë në dyshim çdo vendimmarrje të bazuar në merita në anën e BE-së dhe anulon perspektivën e antarësimit të rajonit. Megjithatë, mosmarrëveshjet dypalëshe të pazgjidhura do të mbesin dhe do të shtohen, duke shkaktuar pasoja të rënda negative për stabilitetin e Ballkanit, i cili mbetet në Evropë. Kjo do të minojë seriozisht përpjekjet e BE-së për të ndërtuar kapacitetet e rezistencës së aleancave të saj. Gjeografia nuk mund të ndryshohet, por vendimet e duhura politike mund të formësojnë të ardhmen gjeopolitike të Bashkimit dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor. Maqedonia e Veriut është anëtare e NATO-s dhe tani është koha gjithashtu që procesi i negociatave të anëtarësimit të bëhet i pakthyeshëm.

Politikat e Bullgarisë tashmë kanë pasoja serioze për të gjithë BE-në: në mungesë të vendosjes së FRONTEX në Maqedoninë e Veriut, e cila tashmë është bllokuar nga "refuzimi i Bullgarisë për të nënshkruar marrëveshjen që përfshin gjuhën maqedonase", kontrolli kufitar do të mbetet i brishtë dhe poroz në një vend kyç që mbylli rrugën Ballkanike.

Politika e zgjerimit të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor - "gjithçka ka marrë tatëpjetën tani".

Po sikur një shtet anëtar të blloktojë një shtet tjetër anëtar për shkak të qëndrimeve të ndryshme historike ose të së drejtës për vetëvendosje? Bllokada e negociatave të pranimit të Maqedonisë së Veriut do t'i jepte fund politikës së zgjerimit të Bashkimit dhe politikës së tij të kushtëzuar. BE-ja në të vërtetë do të ndëshkonte qeverinë më pro-evropiane në rajon për bërjen e kompromiseve në frymën evropiane, të cilat ishin inkurajuar nga vetë BE-ja.

Duke i vënë veton pranimit të Maqedonisë së Veriut në BE, Bullgaria po e bën metodologjinë e negociatave të antarësimit të mbështetur nga Franca të parëndësishme dhe joefikase që në zanafillën e saj. Ajo konfirmon frikën rreth vullnetit të vërtetë të vendeve anëtare për të finalizuar unifikimin e Evropës dhe për të arritur integritetin kontinental me Ballkanin Perëndimor. Kërkesa Bullgare për të përfshirë çështjet dypalëshe në kornizën e negociatave është në kundërshtim me parimin e deklaruar në metodologji për *"të abstenuar nga keqpërdorimi i çështjeve të pazgjidhura në procesin e antarësimit në BE"*.

Mbizotërimi i kushteve të vendosura dypalëshe, të cilat nuk lidhen as me *acquis*, dhe as me standardet ndërkombëtare, do të rrezikojë më tej parimin e parashikueshmërisë, kushtëzimit pozitiv dhe negativ. Kërkesat bullgare për më tepër kompromentojnë kriteret e pranimit nga grupi "Bazat" mbi institucionet demokratike dhe sundimin e ligjit, të cilat mbështeten fuqimisht në standardet e vendosura nga Këshilli i Evropës, organet nën ombrellën e tij dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Pajtueshmëria me përgjegjësitë e antarësimit dhe standardet e vendosura është një detyrim dhe jo një zgjedhje për vendet aderuese të BE-së, si dhe për çdo anëtar të këtyre organizatave, përfshirë të gjitha vendet anëtare të BE-së.

Besueshmëria e shkatërruar e BE-së në Ballkanin Perëndimor - efekti "Shih se kush po flet"

Narrativa e procesit të pranimit në BE në Ballkanin Perëndimor u ndërtua mbi vlerat dhe standardet e BE-së. Ato kanë qenë burimi i legjitimitetit të aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë në Ballkanin Perëndimor të përkushtuar në nxitjen e konsolidimit demokratik përmes sundimit të ligjit, respektimit të të drejtave të njeriut dhe qeverisjes ekonomike. Në vendimin e tij për të hapur negociatat e antarësimit me Maqedoninë e Veriut, Këshilli nuk i vendosi asnjë kusht tjetër konferencës së parë të antarësimit. Një "Jo" e BE-së për procesin e pranimit të Maqedonisë tani si rezultat i kushteve të mëtejshme është një çast vendimtarë për besueshmërinë e të gjithë procesit.

BE e ka promovuar veten si një bashkësi vlerash duke parë përpara, duke pranuar ndryshimet historike dhe duke shndërruar armiqësitë në potencial për zhvillim, duke u përqëndruar në mënyrën se si kombet e saj të bashkëpunojnë dhe integrohen më mirë, dhe jo se si të përballen me njëri-tjetrin. Neni 4 i Traktatit për shtetet e BE *"Bashkimi do të respektojë barazinë e Shteteve Anëtare përpara Traktateve si dhe identitetet e tyre kombëtare"*. Nëse një shtet anëtar bllokoi negociatat e prapambetura të pranimit duke mohuar identitetin e një kandidati, Bashkimi do të humbasë besueshmërinë në rajon, por edhe më gjerë statusin e një aktori normativ me një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë në skenën ndërkombëtare. Qëndrimi ndaj Maqedonisë së Veriut tregon tani një mungesë thelbësore të respektimit të vlerave të vetë BE-së dhe parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtave universale të njeriut dhe minon seriozisht aftësinë e BE-së si një aktor ndërkombëtar.

Maqedonia e Veriut ka dëshmuar përkushtimin e saj ndaj vlerave evropiane. Tani është radha e BE-së që t'u përmbahet vlerave dhe normave të saj ndërkombëtare. Me bllokadën e kornizës së antarësimit të Maqedonisë së Veriut, Bullgaria po shpërdorë pabarazinë e qenësishme të pushtetit në procesin e antarësimit. Me interpretimin e saj të historisë "sonë" të përbashkët rajonale dhe historisë kombëtare të Maqedonisë, mohimi i ekzistencës së rrënjëve historike të kombit maqedonas dhe gjuhës sonë maqedonase, Bullgaria zvogëlon rrezikshëm besueshmërinë e BE-së karshi kandidatëve. Të gjitha vendet e tjera të BE-së kanë përgjegjësinë që të ruajnë procesin e zgjerimit, vlerat e BE-së dhe aftësinë e saj për të marrë vendime të rëndësishme.

Ndërsa qëndrojmë të bashkuar në diversitetin tonë, ne presim që BE t'i qëndrojë besnike parimit 'Të Bashkuar në diversitet',

Është koha për thirrje, mos tradhтони BE-në, rreshtohuni në anën e duhur të historisë dhe ngrini zërin tani!